

LIGJ
Nr.9252, datë 8.7.2004

**PËR PUNËN E KUVENDIT NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË SHQIPËRISË NË
BASHKIMIN EUROPIAN**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e deputetit Ilir Zela,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Objekti i ligjit

Ky ligj ka si objekt vendosjen e rregullave të veçanta për rolin që duhet të luajë dhe punën që duhet të kryejë Kuvendi, si organi më i lartë ligjvënës në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit, me qëllim hartimin e një kuadri të plotë ligjor, mbështetjen dhe mbikëqyrjen e procesit të afrimit të Shqipërisë me Bashkimin Europian.

Neni 2

Mbikëqyrja e Kuvendit

Kuvendi i Shqipërisë ndjek dhe mbikëqyr Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit me Bashkimin Europian, i cili realizohet nëpërmjet dialogut politik, negocimit dhe zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit, Programit CARDS dhe instrumenteve të tjera për koordinimin e përpjekjeve dhe vlerësimin e arritjeve në drejtim të qëllimit të përbashkët.

Neni 3

Përgjegjësitë e Këshillit të Ministrave

Këshilli i Ministrave i dërgon rregullisht Kuvendit informacione mbi punën e bërë pranë institucioneve të ndryshme të Bashkimit Europian dhe vlerësimet e bëra veçanërisht për:

- a) projekt marrëveshjet dhe konventat që duhen lidhur me Bashkimin Europian në kuadër të procesit të afrimit të Shqipërisë me Bashkimin Europian;
- b) projektaktet që kanë të bëjnë me angazhimet në traktatet e Bashkimit Europian, me përjashtim të akteve administrative;
- c) projektaktet e së drejtës komunitare, sidomos lidhur me vendimet e përfaqësuesve të qeverive dhe shteteve anëtare të Bashkimit Europian;
- ç) projektaktet e të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin në mënyrë jo të drejtpërdrejtë dhe që janë të rëndësishme për Republikën e Shqipërisë.

Neni 4

Përgjegjësia e Kuvendit

Kuvendi, në ushtrim të funksioneve të tij sipas Kushtetutës, ligjeve dhe Rregullores së tij, mbikëqyr dhe kontribuon për realizimin e misionit dhe të objektivave të dialogut politik, Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit, Programit CARDS dhe instrumenteve të tjera të bashkëpunimit si më poshtë:

- a) krijimin e kuadrit rregullator të marrëdhënieve politike, institucionale, ekonomike, tregtare dhe ligjore ndërmjet Shqipërisë nga njëra anë dhe Komunitetit Europian e shteteve anëtare të Bashkimit Europian nga ana tjetër;
- b) ndërtimin e kuadrit të përshtatshëm për dialogun politik ndërmjet palëve;
- c) angazhimin më të drejtpërdrejtë për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe më gjerë;
- ç) punën me përparësi për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian.

Neni 5

Kompetencat e Kuvendit

1. Në përmbushje të përgjegjësisë të përcaktuara në nenin 4, Këshilli i Ministrave konsultohet paraprakisht me Kuvendin lidhur me qëndrimet që do të mbajë në institucionet e ndryshme të Bashkimit European. Ky konsultim është i detyrueshëm kur qëndrimet e Këshillit të Ministrave sjellin përfshirjen e Kuvendit dhe kompetencave të tij. Në çdo rast Komisioni i Integritetit jep mendimin e tij. Komisionet e tjera konsultohen paraprakisht për qëndrimet që mbahen dhe negociatat që kryhen, sipas fushës së veprimtarisë së tyre.

2. Kuvendi, në ushtrim të kompetencave të tij, duhet të prononcohet kur e sheh të arsyeshme me një nismë të vetën, lidhur me projektet e legjislacionit dhe të politikës komunitare.

3. Komisioni i Integritetit harton çdo vit raporte, që shërbejnë si bazë për shqyrtimet që do të bëhen në të gjitha komisionet e Kuvendit, sipas fushave të veprimtarisë së tyre.

4. Kuvendi bën çdo vit një vlerësim gjithëpërfshirës të ecurisë së përafrimit të Shqipërisë me Bashkimin European, duke zhvilluar edhe një seancë plenare me debat.

5. Kuvendi, përmes Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, mbikëqyr zbatimin e Programit CARDS dhe të projekteve të tjera me asistencë komunitare.

Neni 6

Zbatimi i asistencës komunitare

Ndërhyrja e Kuvendit në procesin e mbështetjes financiare të afrimit të Shqipërisë me Bashkimin European realizohet brenda ligjit të Buxhetit të Shtetit.

Neni 7

Dokumentacioni european

1. Kuvendi, nëpërmjet shërbimeve të tij, duhet të disponojë një arkiv të vetin me një dokumentacion të plotë e të detajuar për Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit dhe anëtarësimin në Bashkimin European, në të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me integrimin e Shqipërisë në strukturat dhe politikat komunitare. Këto dokumente u vihen në dispozicion të gjithë deputetëve dhe në mënyrë të veçantë Komisionit të Politikës së Jashtme e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Komisionit të Integritetit.

2. Ministria e Punëve të Jashtme vë në dispozicion të Kuvendit çdo informacion të dërguar nga përfaqësia jonë pranë Komisionit European të lidhur me procesin e afrimit të Shqipërisë me Bashkimin European.

3. Deputetët, anëtarë të Komisionit të Politikës së Jashtme e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Komisionit të Integritetit kanë drejtë të kërkojnë e të kenë edhe botime zyrtare të Bashkimit European, të cilat i konsiderojnë të nevojshme për ushtrimin e mandatit të tyre.

Neni 8

Raporti vjetor

Këshilli i Ministrave, gjatë dymujorit të parë të çdo viti, paraqet një raport mbi ecurinë e marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin European gjatë vitit paraardhës.

Në këtë raport duhen analizuar në mënyrë të veçantë vendimet e marra nga institucionet europiane, veprimtaria e të cilave sjell efekte në bashkëpunimin Shqipëri - Bashkimi European, analizohen masat që ka marrë Qeveria si rezultat i këtyre vendimeve, si dhe politikat e ndjekura për të përshtatur politikat sektoriale dhe legjislacionin, që përgatit anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin European.

Neni 9

Fuqia e ligjit në kohë

Ky ligj do të jetë në fuqi dhe do të sjellë efekte juridike deri në anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin European.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4284, datë 29.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**